

trupin e Arbenit i kanë vërejtur disa plagë. E zgjeruan varrin dhe e varrosën Arbenin në të njëjtin vend. Pas lufte, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Arbenit më 6.09.1999 në varrezat e fshatit Klinë të Poshtme/Donja Klina.

**Burimet:** deklarata A.S, FDH-40636; J. Osmani, *Krimet...*, II, 298.

### **Ganimete (Azem) Xhyllani**

(6.04.1979, shqiptare nga Bajica/Banjica, komuna e Glllogocit/Glogovac, e papunë, e pamartuar, pjesëtare e UÇK-së)

Pas mbarimit të shkollës së mesme, Ganimetja kishte dëshirë të regjistronte fakultetin, por hoqi dorë nga kjo ide për shkak të situatës së rëndë materiale dhe ndenji në fshat. Në muajin prill të vitit 1998, ajo aderoi në UÇK. Netët i kalonte zakonisht në shtëpi, përderisa gjatë ditës gjendej në detyrë. Ditën e premte, më 21.08.1998, përderisa gjendej në shtëpi, Ganimeten e ftuan nga njësi i saj. U përshëndet më të ëmën dhe motrat dhe u tha se do të kthehej ditën e hënë. Ditën e diel, më 23.08.1998, Ganimetja ka rënë në betejë me forcat serbe në vendin e quajtur *Fyellit/Frulice* në **Aqarevë/Ovçarevo**. Ditën e hënë, më 24.08.1998, e kanë varrosur në fshatin e saj të Bajicës/Banjica.

**Burimet:** deklarata E.Xh, FDH-31865; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### **Ismet (Hamit) Rrahmani**

(11.06.1962, shqiptar nga Aqareva/Ovçarevo, komuna e Skënderajt/Srbica, drejtor shkollë, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Ismeti ka qenë drejtor i shkollës fillore *Rilindja* në fshatin e tij të Aqarevës/Ovçarevo. Ka aderuar në UÇK menjëherë në fillim të luftës në Kosovë. Ka rënë në luftimet me forcat serbe që u zhvilluan më 27.08.1998 në **Aqarevë/Ovçarevo**. Atje edhe e varrosën një ditë më vonë. Pas lufte, më 27.08.1999, mbetjet mortore të Ismetit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Aqarevë/Ovçarevo. Pas përfundimit të luftës, shkolla e fshatit u riemërtua dhe e mori emrin e ri *Ismet Rrahmani*.

**Burimet:** deklarata A.LI, FDH-36710; SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 112-115; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### **Islam (Osman) Manaj**

(15.09.1956, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, punëtor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### **Faik (Vesel) Millaku**

(7.09.1977, shqiptar nga Ujmiri/Dobra Voda, komuna e Klinës/Klina, bujk, një fëmijë)

Islami dhe Faiku kanë qenë miqtë e ngushtë. Islami ishte pjesëtar i UÇK-së. Për shkak të drojës nga sulmi i mundshëm i forcave serbe, në muajin gusht të vitit 1998 ata që të dy i strehuan familjet e veta në Aqarevë/Ovçarevo, ndërmjet dy tuneleve, ku strehoheshin edhe shumë banorë nga fshatrat përreth. Nga fundi i gushtit, Islami e ka çuar familjen në Llapçevë/Labuçevo [Malishevë/Mališevo] dhe ishte kjo hera e fundit kur ata e shihnin të gjallë. Faiku e ka çuar familjen e tij në fshatin Sverkë/Svrhe [Klinë/Klina], më 1.09.1998. Në datën 2.09.1998, Faiku i telefoni të vëllait në Gjermani. I tha se ai dhe Islami gjendeshin në **Obri të Ulet/Donje Obrinje**. Nga ajo ditë, nuk ekziston asnjë gjurmë për ta. Pas lufte, traktori i Faikut u gjet te postblloku i braktisur policor në Siqevë/Sićevo [Klinë/Klina]. Fati i Islamit dhe i Faikut nuk është i njohur as sot e kësaj dite. Emrat e tyre gjenden në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së dhe janë të sistemuar me numrat BLG-802239-01 dhe BLG-803913-01.

**Burimet:** deklarata R.M, FDH-15412; deklarata H.M, FDH-19695; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### **Ilmi (Veli) Kadriu**

(15.12.1953, shqiptar nga Likoci/Likovac, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, dy fëmijë)

Ilmiu me familje jetonin në *Mëhallën Kadriu* në Likoc/Likovac. Ai ka qenë person me nevoja të veçanta. Forcat serbe e nisën sulmin kundër **Likocit/Likovac** në mëngjesin e datës 11.09.1998. Ilmiu me familje filluan të zhvendoseshin nga fshati. Përderisa po kalonin pranë varrezave, në afërsi të tyre eksplodoi një granatë. Ciflat